

VENDIM
Nr. 221, datë 20.2.2013

PËR CAKTIMIN E ZONAVE TË BREZIT TË GJELBËR TË QYTETIT TË
TIRANËS DHE TË RRETHINAVE TË TIJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, 20/3 dhe 23 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2001 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe të pikës 4 të nenit 27 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e zonave për krijimin e brezit të gjelbër të qytetit të Tiranës dhe të rrethinave të tij, sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Zonat që përbëjnë brezin e gjelbër kanë një sipërfaqe të përgjithshme prej 4 233.1 (katër mijë e dyqind e tridhjetë e tre pikë një) ha, të ndarë si më poshtë vijon:

Zonat e brezit të gjelbër të Tiranës		
Nr.	Emërtimi	Sipërfaqja ha
1	Liqeni i Tiranës	237.1
2	Sauk-Lundër	825.1
3	Lundër-Mullet	209.7
4	Liqeni i Farkës	296.8
5	Mullet-Farkë	1,311.0
6	Zall-Herr	437.8
7	Liqeni i Paskuqanit	267.3
8	Brar-Linzë	364.1
9	Linzë	110.9
10	Mëzez-Kashar	173.3
	TOTALI	4,233.1

3. Kufijtë e zonave të brezit të gjelbër të qytetit të Tiranës dhe të rrethinave të tij përshkruhen në shtojcën bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Brezi i gjelbër krijohet në nivel qarku, bashkie dhe komune, duke përcaktuar sipërfaqen, sipas zonave, që synohet të shpallet brez i gjelbër, kufijtë dhe shkallën e ruajtjes së tij, sipas zonimit të territorit.
5. Institucionet qendrore e vendore dhe çdo organ tjetër publik ka detyrë e përgjegjësi për planifikimin e territorit dhe kontrollin mjedisor të brezit të gjelbër, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT), në bashkëpunim me autoritetet e planifikimit të çdo niveli, duhet të kontrollojë zbatimin dhe përputhshmërinë e këtij vendimi me të gjitha instrumentet e planifikimit vendor dhe kombëtar, të cilat do të hartohen në të ardhmen për zonat e brezit të gjelbër.
7. Në rregulloren e planifikimit të territorit, ndarja e sipërfaqes së brezit të gjelbër në nënzona përdorimi të bazohet në rëndësinë e vlerave të veçanta natyrore, të llojeve floristike e faunistike, të tokës bujqësore, pyjeve, kullotave, zonave të mbrojtura dhe monumenteve natyrore, të peizazhit dhe karakteristikave unike gjeografike, liqeneve, ujëmbledhësve, lumenjve e përrenjve, të vlerave historike, kulturore, arkeologjike e monumentale dhe të trashëgimisë natyrore e kulturore të zhvillimeve urbane, shërbimeve mbështetëse dhe krijimit të kushteve për zhvillimin e veprimtarive rekreative, çlodhëse, argëtuese, sportive dhe ekoturistike.
8. Në planifikimin e territorit, sipas specifikave të çdo zone të brezit të gjelbër, të përcaktohen:
 - kategoritë dhe strukturat e lejuara, të kushtëzuara, të ndaluara, kushtet dhe normat e përdorimit të tyre brenda secilës zonë të brezit të gjelbër;
 - llojet e punimeve, të veprimtarive, të shërbimeve dhe të pritjes e të argëtimit të vizitorëve;

- kushtet e sigurisë së jetës publike dhe të përshtatshmërisë për lëvizje për personat madhorë, me aftësi të kufizuar dhe kategori të tjera;
 - nënzonat e veçanta pa ndërtime, por vetëm për shëtitjet në natyrë të lirë dhe të strukturave përkatëse, si shtigjet, stolat, belvedere, çezma, nyje sanitare etj., në shërbim të vizitorëve;
 - nënzonat e veçanta e të kufizuara për ngritjen e strukturave të shërbimeve mbështetëse, shëndetësore e të nyjave sanitare, të tregtisë dhe të biznesit;
 - nënzonat e kufizuara për parkimin e çdo lloj automjeti;
 - nënzonat e veçanta për argëtim dhe veprimtari sportive;
 - veprimtaritë dhe ndërtimet e çfarëdolloji, që kanë ndikim të ndjeshëm në mjedis dhe që nuk janë në përputhje me qëllimin dhe funksionimin e zonave të brezit të gjelbër, të cilat duhet të pezullohen e të prishen;
 - planifikimi dhe administrimi i territorit për sipërfaqet e tokave, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar;
 - masat për rehabilitimin e digave dhe të pasqyrës ujëmbledhëse të liqeneve/rezervuarëve, për të rritur sigurinë dhe kthimin e tyre në mjedise çlodhëse, argëtuese, sportive dhe të peshkimit sportiv;
 - masat për rigjallërimin e pyjeve, të ripyllëzimit me lloje vendase dhe dekorative, në përputhje me funksionet e brezit, të pranueshme për peizazhin dhe të pëlqyer nga banorët dhe vizitorët;
 - masat që duhet të merren për rehabilitimin e mjedisit natyror të dëmtuar dhe ndaj erozionit.
9. Studimi dhe rregulloret për zhvillimin e brezit të gjelbër miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT).
10. Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (INUK) dhe strukturat inspektuese të ministrive dhe të institucioneve vendore, sipas përkatësisë dhe kompetencave ligjore, në fuqi, ushtrojnë kontrolle për miradministrimin e brezit të gjelbër të qytetit të Tiranës dhe të rrethinave të tij, si dhe për zbatimin e planit të zhvillimit.
11. Ngarkohen institucionet qendrore, Këshilli i Qarkut, njësitë e qeverisjes vendore dhe strukturat inspektuese për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha